Breaking News: Elbasan – Tentoi të korruptonte punonjësin e Policisë Rrugore, arrestohet




*04/08/2025*

# Durrës – Qëlluan Me Armë Zjarri, Në Drejtim Të Automjetit Me Të Cilin Lëvizte Një 35-Vjeçar, Identifikohen Dhe Shpallen Në Kërkim 2 Shtetas

Në vijim të veprimeve hetimore në lidhje me ngjarjen e ndodhur rreth orës 01:00 të datës 03.08.2025, në autostradën "Durrës-Tiranë", ku u qëllua me armë zjarri, në drejtim të automjetit me të cilin lëvizte shtetasi L. Sh., 35 vjeç, specialistët për Hetimin e Krimeve të Rënda të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës identifikuan dhe shpallën në kërkim shtetasit E. D., 46 vjeç dhe E. D., 40 vjeç, vëllezës, të dy banues në fshatin Xhafzotaj.

Nga hetimet e deritanishme dyshohet se pasi janë konfliktuar verbalisht, me 35-vjeçarin, për parakalimin me automjet, vëllezërit kanë qëlluar me armë zjarri, në drejtim të automjetit me të cilin lëvizte ai.

Nga të shtënat u dëmtua 35-vjeçari, i cili është jashtë rrezikut për jetën.

Punohet intensivisht për kapjen e 2 shtetasve të shpallur në kërkim.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Durrësit, për veprime të mëtejshme.

Elbasan – Tentoi të korruptonte punonjësin e Policisë Rrugore, arrestohet

Peqin – Dogji një sipërfaqe toke dhe disa pemë ulliri, në fshatin Fatishë, identifikohet dhe procedohet penalisht

## Kërko

Enter a word for search

## Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

## Arkiva

Select Month

## Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent

Copyright © 2025 Policia e Shtetit. All rights reserved. Theme: ColorNews by ThemeGrill. Powered by WordPress.